



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.70
Prishtinë, më 24 shtator 2024, në orën:11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Isak Shabani, Fidan Jilta, Adelina Grainca, Nijazi Isaku, Besim Muzaqi, Fitim Haziri, Agim Veliu dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Mergim Lushtaku.

Në mbledhje morën pjesë: MAPL, OSBE, KCSF, KDI, Labinot Smakaj dhe Muhamet Bytyqi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi Valon Ramadani, kryetar i komisionit, me këtë:

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për sesionin vjeshtor 2024;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-285 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Para se të miratohej rendi i ditës,

Isak Shabani, kërkoi sqarime lidhur me dy çështje të cilat nuk ishin inkorporuar si pika të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së zyrtarëve të IT në komuna dhe mocioni i grupit parlamentar të PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Besnik Tahiri, kërkoi që kërkesa e zyrtarëve të IT në komuna, të shqyrtohet urgjent për arsye se të njëjtit janë të diskriminuar në paga në raport me kolegët e tyre të nivelit qendror.

Valon Ramadani, lidhur me mocionin e grupit parlamentar të PDK-së, tha se sipas Rregullores së Kuvendit, mocioni duhet të shqyrtohet në afat prej 14 ditësh, ndërsa që afati prej 14 ditësh ka skaduar.

Konstatim: rendi i ditës u miratua me ndryshime, me propozimin e anëtarëve të komisionit, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri dhe Nijazi Isaku dhe me miratimin e anëtarëve të tjerë të komisionit, pika e katërt e rendit të ditës u shty për shqyrtim dhe u caktua mbajtja e një punëtorie në të cilën do të ftohen të marrin pjesë grupet e interesit dhe institucionet tjera që kanë paraqitur komente dhe propozime për P/ligjin.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

Procesverbalet e mbledhjeve të kaluara u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për sesionin vjeshtor 2024;

Valon Ramadani, njoftoi anëtarët e komisionit, se mbi bazë të Programit Legjislativ të Qeverisë dhe Rregullores së Kuvendit, Komisionet parlamentare i hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve për sesionin vjeshtor 2024.

Draft-Plani i punës së komisionit i përgatitur në bazë të Programit Legjislativ të Qeverisë mund të plotësohet me propozime shtesë, lidhur me këtë pyeti anëtarët e komisionit nëse kanë për të shtuar apo plotësuar draft - planin e punës.

Besnik Tahiri, propozoi që në plan të punës për muajin tetor të ftohet për raportim ministri i MPB për të raportuar për Ligjin për Paga dhe Ligjin për Zyrtarët publik si dhe të mbahet një takim pune rreth punës mandatore të komisionit.

Konstatim: Komisioni miratoi Planin e Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës;

Valon Ramadani, njoftoi anëtarët e komisionit, se Kuvendi i Kosovës me Vendimin nr. 08-V-712, dt. 04 prill 2024 ka ngarkuar Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, si komision funksional për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës.

Komisioni shqyrtoi Projektligjin nen për nen dhe hartoi këto propozim – amendamente si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1, fshihet fjala “**rishqyrtimin**”, zëvendësohet me fjalën “**shqyrtimin**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 1, fshihet në tërësi.

Amendamenti 3

Neni 2, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

“Ky ligj zbatohet nga komunitat, ministritë dhe çdo organ tjetër që ka kompetenca të rishqyrtimit të akteve të komunës”.

Amendamenti 4

Neni 8, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6, fshihet në tërësi.

Amendamenti 5

Neni 9, paragrafi 4, fshihen fjalët “**ka të drejtën e paraqitjes së padisë**”, zëvendësohen me fjalët “**duhet të paraqes padi**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 6

Neni 14, fshihet në tërësi, ndërsa nenet në vazhdim rinumërohen.

Amendamenti 7

Neni 15, ndryshohet si vijon: “**Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, nxirren jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji**”.

Konstatim: Pas shqyrtimit të Projektligjit në fjalë, me 6 vota “Për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni miratoi propozimet dhe vendosi që komisioneve kryesore t`ua paraqesë raportin me amendamente për shqyrtim dhe miratim

5. Të ndryshme.

Isak Shabani, kërkoi për mbledhjen e radhës të shqyrtohet kërkesa e zyrtarëve të IT dhe mocioni i grupit parlamentar të PDK-së për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Valon Ramadani, përkrahu kërkesën e deputetit Shabani që të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e radhës kërkesa e zyrtarëve të IT, ndërsa sa i përket mocionit për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, tha se ka kaluar afati për shqyrtimin e mocionit dhe komisioni nuk ka mund ta shqyrtojë, por e keni të drejtën që këtë mocion ta procedoni për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën: 13:55.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Valon Ramadani,
Kryetar i Komisionit
